18845

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr._____i Vendimit

- V E N D I M -

PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot me date 20-02- 1998 (nentedhjetetete), une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Mr. Deda, pasi studjova materialet e paraqitura nga Shoqeria Tregtare " M.C. INERTE" SH.P.K. me ortake z. MARK LULI dhe POLESEL CLAUDIO per tu regjistruar si person juridik,

K O N S T A T O V A ,

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " M.C. INERTE " sh.p.k. ka paraqitur kerkese per tu regjistruar si person juridik per te fituar zotesine per te vepruar.

Objekti i veprimtarise se saj do te jete :
Prodhim materiale inerte, betoni asfalti, prodhime materiale ndertimi te te gjitha llojeve, ndertime te ndryshme civile, shtrim rrugesh, ndertime industriale, turistike germime dheu etj.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr: " Durresit", nr 15.

Administrator i shoqerise eshte Z. MARK LULI dhe POLESEL CLAUDIO

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 10 vjet te njepasnjeshme.

Nga meterialet e paraqitura rezulton se veprimtaria e shoqerise eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Nenit 5 te Ligjit Nr.7512 date 10.8.1991 dhe Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992,

V E N D O S A

Te regjistroj ne gjykate si person juridik qe fiton zotesine per te vepruar, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " M.C. INERTE " me ortake MARK LULI dhe POLESEL CLAUDIO per te ushtruar veprimtarine tregtare ne fushen e :

a.Prodhim materiale inerte, betoni, asfalti, prodhime materiale ndertimi te te gjitha llojeve, ndertime te ndryshme civile, shtrim rrugesh, ndertime industriale, turistike, germime dheu etj.

Kapitali i shoqerise do te jete 100.000 leke.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane Rr e Durresit, Nr 15.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise do te jete 10 vjet te njepasnjeshem.

Administrator i shoqerise do te jete Z POLESEL CLAUDIO dhe MARK LULI.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR 12845/1 VENDIMI

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tiarne sot me date 01. 06.2001, une Zegjine Sollaku gjyqtare ne Gjykaten e Rrethit Tirane, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mark LULI dhe dokumentat bashkengjitur kerkeses, me objekt depozitimin e vendimit nr.1, date 28.05.2001, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "M.C.INERTE " SH.P.K, Tirane ,

K O N S T A T O V A

Gjykata e Rrethit Tirane, me vendim nr. 18845 date 20.02.1998 ka vendosur regjistrimin si person juridik te shoqerise "M.C. INERTE " Sh.P.K

Me vendimin nr. 1 date 28.05.2001, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "M.C. INERTE " eshte vendosur;

Shtese e objektit te veprimtarise se shoqerise per aktivitetin ndertim sipas kategorive te liçesenses se drejtuesit teknik.

Kerkesa e tij eshte e mbeshtetur ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7632 date 4.11.1992 dhe te ligjit 7638 date 19.11.92 dhe t ligjit 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses..

Depozitimin ne regjistrin tregetar te vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "M.C.INERTE "SH.P.K nr. 1 date 28..05.2001.

Urdherimin e zyres se regjistrit tregetar per te bere ndryshimet ne kolonat perkatese.

G J Y Q T A R E

Zegjine Sollaku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 18.849/3 VENDIMI

V E N D I M
"I GJYQTARIT TE VETEM "

Ne Tirane sot me dt 17-06-2002 , une gjyqtare M. Deda, ne Gjykaten e shkalles se pare Tirane , pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mark Luli dhe dokumentat bashkengjitur kerkeses , me objekt depozitimin e vendimit date 25.05.2002 te asamblese se ortakeve te shoqerise "M.C.INERTE" Sh.P.K Tirane

K O N S T A T O V A

Gjykata e shkalles se pare Tirane me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 ka vendosur regjistrimin person juridik te shoqerise "M.C.INERTE " Sh.P.K Tirane .

Me vendimin dt 25.05.2002 te asamblese se ortakeve te shoqerise ""M.C.INERTE " Sh.P.K Tirane , u vendos :

-Te shtoj objektin e veprimtarise edhe me tregetimin me shumice e pakice te te gjitha materialeve te ndertimit

-Te behet rritja e kapitalit te shoqerise ne natyre .

-Ti drejtohen gjykates se shkalles se pare Tirane , per te emeruar ekspert kontabel per vleresimin e pasurise ne natyre .

Kerkesa e tij eshte e mbeshtetur ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te Ligjit Nr 7632 dt 4.11.1992 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te Ligjit 7667 dt 28.01.1993 dhe Ligjit Nr 8770 dt 19.04.2001

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses .

Depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve dt 25.05.2002 per shtimin e objektit te veprimtarise tregetim me shumice dhe pakice te gjitha materialeve te ndertimit.

Caktimin si ekspert per te bere vleresimin e pasurise per efekt te shtimit te kapitalit Z.Teit Gjinaj ekspert kontabel i miratuar me Nr license 68.

GJYQTARE
Mariana Deda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR VENDIMI

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tiarne sot me date 06 03.2002, une Danila Capo gjyqtare ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mark LIKA dhe dokumentat bashkengjitur kerkeses, me objekt depozitimin e vendimit nr.1, date 12.02. 2001 te Asamblese Se Ortakeve te Shoqerise "M.C INERT" SH.P.K Tirane ,

K O N S T A T O V A

Gjykata e Rrethit Tirane me vendim nr.18845 date 20.02.1998 , ka vendosur regjistrimin si person juridik te shoqerise "M.C INERT" SH.P.K Tirane ,

Me vendimin nr. 1, date 12.02. 2001 te Asamblese Se Ortakeve te Shoqerise "M.C INERT" SH.P.K Tirane , u vendos:

- Shitje e kuotave te kapitalit te shoqerise nga ortaku Claudio POLESEL ne masen 50% , ortakut Mark LULI i ctak i vetem i kesaj shoqerie me 100 % te k uotave te kapitalit.

Kerkesa e tij eshte e mbeshtetur ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7632 date 4.11.1992 dhe te ligjit 7638 date 19.11.92 dhe t ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit nr. 8770 date 19.04.2001,

V e n d o s a

Pranimin e kerkeses..

Depozitimin ne regjistrin tregetar te vendimit te nr. 1 date 12.02. 2001 te Asamblese Se Ortakeve te Shoqerise "M.C INERT" SH.P.K Tirane.

Depozitimin e kontrates se shitjes se kuotave nr. 211 rep dhe 36 kol date 12.01.2002 dhe te deklarates noterjale nr. 1209 rep dhe 276 kol date 28.02.2002.

Urdherimin e zyres se regjistrit tregetar per te bere ndryshimet ne kolonat perkatese.

G J Y Q T A R E
Danila Capo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 18845/6 VENDIMI

V E N D I M
" I GJYQTARIT TE VETEM "

Ne Tirane sot me dt 11.10.----2002 une gjyqtare - M. Doga -------
e gjykates se shkalles se pare Tirane , pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mark Luli ortak i vetem dhe administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "M.C.INERTE " Sh.P.K dhe

K O N S T A T O V A

Se shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " M.C.INERTE "Sh.P.K eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 ku aktualisht ortak i vetem dhe administrator eshte Mark Luli.

Me vendimin Nr 6 te ortakut te vetem dt 09.10.2002 ka pranuar ne shoqeri si ortake Ilir Shtufi dhe Xhemal Shtufi.

Me kontraten e shitjes dt 09.10.2002 u ka shitur ortakeve Ilir Shtufi dhe Xhemal Shtufi pjese nga kapitali i shoqerise ne masen 25% secilit, perkatesisht ne shumen 11.275.000 leke , kurse vete ortakut Mark Luli i ka mbetur pjesa 50% ne shumen 22.550.000 leke .

Ortaket kane marre persiper detyrimet e aktivit dhe pasivit te shoqerise nga momenti i hyrjes si ortake ne shoqeri.

Kerkoj depozitimin e dokumentave ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Gjykata ne baze te Ligjit 7638 dt 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe ligjit 7667 dt 28.01.1993 " Per regjistrat tregtar "

V E N D O S A

-Pranimin e kerkeses.

-Depozitimin e dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise " M.C.INERTE" Sh.P.K , vendimin Nr 6 dt 09.10.2002 te ortakut te vetem dhe kontraten e shitjes se kuotave Nr 2877 rep dt 09.10.2002 .

-Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar te bej ndryshimet ne fleten e regjistrit ne kolonen ------.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe .

GJYQTARE
Mayelinda Doga

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 188545/5 VENDIMI

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 8.1.7.... 2002 une gjyqtarja ..E. .Bej..... e gjykates se shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen e administratorit Mark Luli per depozitimin e dokumentave ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "M.C.INERTE " Sh.P.K

K O N S T A T O V A

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .Aktualisht eshte ortak i vetem dhe administrator Mark Luli me gjendje kapitali te regjistruar 100.000 leke .Me daten 20.06.2002 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurise se saj dhe ka kerkuar nga gjykata caktimin e ekspertit .Gjykata e shkalles se pare Tirane me vendimin Nr 188845/4 ka caktuar ekspert z.Teit Gjini.

Esperti pasi ka vleresuar kredite e dhena nga ortaket per blerjen e aktiveve te qendrueshme dhe per kapital punues ka bere raportin e ekspertit kontabel .

Ortaku i vetem me dt 20.06.2002 ka vendosur ;

-Te miratoj raportin e ekspertit kontabel paraqitur nga eksperti Teit Gjini per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "M.C.INERTE " nga 100.000 leke ne 45.100.000 leke nepermjet blerjes se aktiveve te qendrueshme dhe per kapital punues.

-Per rritjen e vleres nominale te kuotes se kapitalit ne masen 451.000 duke mbajtur te pandryshuar numrin e kuotave 100.

- te regjistrohet kapitali 45.100.000 leke ne Zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane.

Kapitali i shoqerise pas ketij zmadhimi do te jete ne pronesi te ortakut ne vleren 45.100.000 leke qe i perket mases 100%.

Adminsirtatori kerkon te depozitohen ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se pare Tirane vendimi i ortakut te vetem dt

20.06.2002 , raporti i ekspertimit kontabel te paraqitur nga eksperti Teit Gjini.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregatare" dhe ligji nr. 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar" .

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses .

-Depozitimin ne Zyren e regjistrit tregtar te dokumentave te paraqitur ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " Sh.p.k qe jane vendimi i ortakut te vetem dt 20.06.2002 , raporti i eksperti kontabel te paraqitur nga eksperti Teit Gjini.

-Urdherimin e Zyres se regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen . . . . . ne regjistrin tregtar.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 188 45/7 VENDIMI

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me dt -20/1/----------2004 , une gjyqtari M. Doçi----------
--------e Gjykates se shkalles se pare Tirane , pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Mark Luli

K O N S T A T O V A

Se shoqeria "M.C.INERTE " Sh.P.K eshte regjistruar person juridik me vendimin e Gjykates se shkalles se pare Tirane Nr 18845 dt. 20.02.1998

Me vendimin Nr 7 te asamblese se ortakeve eshte vendosur :

1.Shitja e kuotave te shoqerise nga Z.Ilir Shtufi dhe Xhemal Shtufi tek Mark Luli . Me kontraten e shitjes Nr 90 rep dt. 07.01.2004 eshte bere shitja e kuotave qe ka pasur z.Xhemal Shtufi dhe Ilir Shtufi ne masen 25% secili qe i perket vleres 11.275.000 leke per secilin tek Mark Luli dhe Z.Mark Luli mbetet ortak i vetem dhe administrator i shoqerise qe ka 100% te kapitalit .

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit 7667 dt 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e dokumentave te shoqerise "M.C.INERTE " shpk , vendimin e asamblese se ortakeve nr 7 dt 07.01.2004, kontraten e shitjes se kuotave te kapitalit Nr 90 dt. 07.01.2004 per largimin e ortakeve Ilir Shtufi dhe Xhemal Shtufi te shoqerise "M.C.INERTE "Sh.P.K .

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri.

Te behen ndryshimet ne kolonen - - - - - -

GJYQTARE
Mylinda Doçi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 21/12/.... 2004 une gjyqtarja A. Kuoxhia... e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen e administratorit Mark Luli per depozitimin e dokumentave ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " M.C.INERTE " Sh.P.K

KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .Aktualisht eshte ortak i vetem dhe administrator Mark Luli me gjendje kapitali te regjistruar 45.100.000 leke. Me daten 02.12.2004 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurise se saj dhe ka kerkuar nga gjykata caktimin e ekspertit .Gjykata e Shkalles se pare Tirane me vendimin Nr 18845/8 dt 03.12.2004 ka caktuar ekspert z.Teit Gjini.

Esperti pasi ka vleresuar kapitalin e shoqerise e dhene nga ortaku ka bere raportin e ekspertit kontabel .

Ortaku i vetem me vendimin Nr 9 dt 14.12.2004 ka vendosur ;

-Te miratoj raportin e ekspertit kontabel paraqitur nga eksperti Teit Gjini per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "M.C.INERTE " nga 45.100.000 leke ne 52.803.465 leke i cili vjen si rezultat i kalimit te fitimeve te mbartura deri me 31.12.2003 ne kapitalin themeltar.

- Te regjistrohet kapitali 52.803.465 leke ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

-Kapitali i shoqerise pas ketij zmadhimi do te jete ne pronesi te ortakut ne vleren 52.803.465 leke qe i perket mases 100%.

Administratori kerkon te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 14.12.2004, raporti i ekspertimit kontabel te paraqitur nga eksperti Teit Gjini dt 14.12.2004.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregatare" dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar" .

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses .

-Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitur ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" Sh.P.K qe jane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 14.12.2004 , raporti i eksperti kontabel te paraqitur nga eksperti Teit Gjini dt 14.12.2004.

-Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen . . . . . ne Regjistrin Tregtar.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 18845/8 VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 31.12.... 2004 une gjyqtarja ..... e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen e administratorit Mark Luli per depozitimin e dokumentave ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "M.C.INERTE" Sh.P.K

KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr.18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Aktualisht shoqeria perbehet nga ortaku i vetem dhe administrator Mark Luli me kapital te regjistruar 451.000.000 leke .Me daten 02.12.2004 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me burim nga fitim i pashperndare .Per te bere vleresimin e kesaj pasurie ka kerkuar emerimin si ekspert te Z.Teit Gjini.

Administratori kerkon te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane vendimin e ortakut te vetem Nr 8 dt 02.12.2004.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregatare" dhe ligji nr. 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar" .

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses .

-Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te vendimit te ortakut te vetem Nr 8 dt 02.12.2004 ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " Sh.P.K duke caktuar si ekspert Z.Teit Gjini.

-Urdherimin e Zyres se regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen ..4.4..... ne regjistrin tregtar.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 18845/10 VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date ..11/7/.. 2005 une gjyqtarja ..6..3/1..... e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane pasi shqyrtova kerkesen e administratorit Mark Luli per depozitimin e dokumentave ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " M.C.INERTE " Sh.P.K

KONSTATOVA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " M.C.INERTE" eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .Aktualisht kjo shoqeri perbehet nga nje ortak Mark Luli me administrator Mark Luli , me gjendje kapitali te regjistruar 52.803.465 leke . Me daten 06.07.2005 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me kontribut ne para.

Zmadhimi i kapitalit eshte ne shumen 11.300.222 leke Ky kontribut ne para vertetohet nga konferma bankare Nr 0097015 dt 06.07.2005.

Ky kapital pas ketij zmadhimi do te behet 64.103.687 leke.

Administratori kerkon te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 06.07.2005.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregatare" dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar" .

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses .

-Depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitur ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" Sh.P.K qe jane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 06.07.2005.

-Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen ..... ne Regjistrin Tregtar.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTAR

1/ Tirana

2/ a. "M. C. inerta" sh.p.k

b. Sh. "Durrës", Nr 15 Tiranë.

c. prodhim materiale inerte, beton asfalti, prodhime materiale ndërtimi industriale, furnizim gëlqime dheu.

ç. 100 000 lekë.

3/ Mark Kuli 50 %
Foleze Alandro 50 %

Adm:

1. Mark Kuli
2. Foleze Alandro

4/ 10 vjeçar

M - 2 fleta
F - 9 fleta"

19-02-98
20-02-98

- Vërtetim ke noter. Nr. 5 noter.
- Licence Nr. Z 0100 M. Sadiku
(Edmond Haxhitari) dt 24-5-95

18845

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

" M.C. INERTE." SH P K

Sot me date 18.2.1998, ketu ne Tirane, ne te quajturit

I- POLESEL CLAUDIO, i dt 1955, banues ne Tirane , madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte 361488J.

2- MARK LULI, i dt 1962, lindur ne Puke , madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte 0500148.

vendosem te krijojme nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "

"M.C. INERTE. " shpk, me kushtet qe vijojne :

1) Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Prodhim materiale inerte, betoni, asfalti, prodhime materiale ndertimi te te gjitha llojeve , ndertime te ndryshme civile, shtrim rrugesh, ndertime industriale, turistike, germime dheu etj.

2) Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar.

3). Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj vetem pas rregjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

4) Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

5) Ajo mund te hape edhe zyra perfaqsimi apo filiale te saj ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj per realizimin e aktivitetit te saj.

6) Kapitali themelues i shoqerise eshte 100.000 leke, i derdhur ne para teresisht. Kapitali themelues nenshkruhet si vijon :

- CLAUDIO POLESEL .....50 %

MARK LULI.....50%

7) Shoqeria do te kete dy Administratore te cilet jane dy ortaket, ndersa Drejtues Teknik z. EDMOND HALLTARI.

8) Shoqeria do te paiset me dokumentin perkates me regjistrimin prane organit tatimor.

9) Fitimi qe do te rezultoje, pas heqjes se shpenzimeve te aktivitetit te njohura me ligj dhe pas zbritjes se shumave te tatimit, do te disponohet sipas vendimit te ortakeve.

10) Dispozita me te detajuara ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e shoqerise jane percaktuar ne statutin e Shoqerise bashkengjitur.

ORTAKET

CLAUDIO POLESEL MARK LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR 1485 REP

NR 387 KOL

VERTETIM

Sot ne daten 18.2.1998 perpara meje Noteres Mimoza Sadushi, u paraqiten personalisht palet e mesiperme madhore me zotesi juridike per te vepruar te cilet deklaruan se kane hartuar jashte kesaj zyre aktin e mesiperm i cili shpreh vullnetin e tyre dhe pasi e nenshkruan ate perpara meje une e verteto ate sipas ligjit.

PULLE TAKSE 20 LEKE R.SHQIPERISE

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
TEL 349-59

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" M.C. INERTE " SH. P. K.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " M.C. INERTE" SHPK, Tirane, eshte person juridik I pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 7512 date 10 gusht 1991, Kodit Tregtar dhe akteve te tjera ligjore.

NENI 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

NENI 3

Themeluesi I shoqerise ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

NENI 4

Shoqeria "M.C. INERTE " shpk, Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.

EMRI, QENDRA, TERRITORI

NENI 5

Emertimi I shoqerise do te jete : Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar " M.C. INERTE " SH.P.K. Tirane.

NENI 6

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, Rr: " Durresit ",nr 15.
Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te cele filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

AFATI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Aktiviteti tregetar I Shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

OBJEKTI

NENI 8

Objekti I veprimtarise private te Shoqerise " M.C. INERTE " shpk, do te jete:
Prodhim materiale inerte betoni, asfalti, prodhime materiale ndertimi te te gjitha llojeve, ndertime te ndryshme civile, nndertime dhe meremetime rrugesh,ndertime industriale,turistike,gemime dheu etj..

NENI 9

Shoqeria "M.C. INERTE " shpk, mund te ndryshoje aktivitetin e saj. Ndryshimet ne aktivitetin e shoqerise, selise dhe shtimin e kapitalit te saj, behen vetem me vendim te Ortakeve te shoqerise .

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 10

Kapitali themeltar i shoqerise " M.C. INERTE " shpk, perbehet nga kontributi fillestar I themeluesve te shoqerise ne vleften prej 100 000 leke (njeqintmije).
i ndare ne 50.000 leke Claudio Polesel dhe 50.000 leke Mark Luli

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

NENI 11

Transferimet e kapitalit fillestar duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria duhet te respektoje keto transferime sapo ti behen te ditura asaj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane te tranferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund t'u kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 13

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme edhe ne favor te te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri me pelqim te themeluesit. Ortaku qe ka ndermend te cedoje, qofte edhe pjeserisht pjeset e tij te kapitalit, fillimisht duhet ti komunikoje shoqerise projektin e transferimit.

NENI 14

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, me marreveshje, pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.Shoqeria fiton te drejten e personit juridik me regjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe ne organet e finances shteterore.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 15

Shoqeria "M.C. INERTE " shpk Tirane, do te kete si Administrator z.CLAUDIO POLESEL dhe MARK LULI. Themeluesi I shoqerise ka ne kompetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut.

NENI 16

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.Drejtuesi teknik i shoqerise do te jete z.Edmond Alltari.

Neni 17

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj, Ne rastet kur administratori eshte I emeruar nga themeluesi I shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kompetencen e themeluesit te shoqerise.

NENI 18

Ortaket themelues kane ne kompetence: Te miratojne programin e shoqerise, te hartojne raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat
hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar;
Vendosin per shperberjen e shoqerise;
Vendosin per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
Rregullojne marredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise;
Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas a te huaj.
Te gjitha vendimet e rendesishme per ndryshime ne statut merren me 100% te kapitalit te shoqrise.

NENI 18

Ne rast se administrimi I shoqerise kryhet nga nje administrator I zgjedhur posacerisht nga ortaket themelues, keta te fundit miratojne aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe ka te drejte te informohen personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

NENI 19

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaket themelues te shoqerise. Ne rastin e fundit, shkarkimi I administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te themeluesve te shoqerise. Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

MAREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 20

Shoqeria " M.C. INERTE " shpk, mune te lidhe kontrata me sektoret shteterore drejteperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas e te huaj, sipas lregjislacionit ne fuqi per ekspor-importet.

NENI 21

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqsohet nga orteket CLAUDIO POLESEL dhe MARK LULI ose persona te tjere te autorizuar prej tyre.

NENI 22

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

NENI 23

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore, etj. Sipas ligjit te tatimin mbi fitimin percaktohen tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise.
Shoqeria ka te drejte te cele llogari likujduese prane bankave te vendit e te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

NENI 24

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose valute te huaj.

NENI 25

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj e anasjelltas, mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat valutor.

NENI 26

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas cmimeve qe I cakton vete shoqeria. Cmimet dhe tarifat dhe te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

NENI 27

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte, shoqeria paguan nje tatim ne perqindje te shumes se fitimit qe transferohet.

NENI 28

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar, administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortaku I vetem themelues, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 29

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne fund te vitit kalendarik. Administratoret jane te mdetyruar te paraqesin bilance preriodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

<u>MAREDHENIET E PUNESIMIT</u>

NENI 30

Themeluesi I shoqerise vendos per shtimin ose paksimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e Shoqerise " M.C. INERTE " shpk.

NENI 31

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratoret e shoqerise pasi te jete marre me pare pelqimi I themeluesve te shoqerise .

NENI 32

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise si dhe duke njoftuar organet e punes te jurisdiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

NENI 33

Ortaket, administratori dhe punonjesit te tjere te shoqerise, jane te detyruar te respektojne disiplinen e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjes e saj.

NENI 34

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise, zbatohen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesit e shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

NENI 35

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kritereve te caktuara nga ortaku I vetem themelues ose nga ortaket kur jane disa te tille dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate, sipas ligjeve te shtetit shqiptar.

NENI 36

Punonjesit gezojne leje vjetore dhe leje plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

NENI 37

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te dorezoje detyren ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likujduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti I mesiperm mbahet nga administratori I shoqerise.

<u>BILANCI DHE TE ARDHURAT</u>

NENI 38

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te ortakeve themelues dhe ndahen sipas kontributit te sejcilit.

NENI 39

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise " M.C. INERTE " shpk Tirane, caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesit e shoqerise ose nga ortaket, ne rast se shtohet numri I tyre.

NENI 40

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze.

NENI 41

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi I vitit financiar, te cilit I jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

NENI 42

Kur pushon aktiviteti I shoqerise , kapitali I mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, ndahet midis ortakeve sipas kontributit te sejcilit ose I mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere.

NENI 43

Fitimi I mbetur kalon ne pronesi te ortakeve themelues pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundshme per punonjesit e shoqerise.

<u>SHPERBERJA E SHOQERISE</u>

NENI 44

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket themelues vendosin brenda 4 muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

NENI 45

Gjykata mund ti ofroje shoqerise nje afat maksiomal prej 6 muaj per te rregullaur gjendjen. Ajo nuk mund ta prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne diten ne te cilen ajo mblidhet per te marre vendim.

NENI 46

Ne rast se shoqeria nuk prishet , detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbeture pa mbuluar, duke patur parasysh qe shuma e kapitalit te mbetur te jete mbi 100.000 leke.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 47

Themeluesi ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe hartoje dhe kontraten e perbashket me ortaket e tjere duke bere ndryshimet e nevojshme ne regjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane,

NENI 48

Mosmarreveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 49

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, I referohet ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise" si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

NENI 50

Staturi perpilohet ne disa kopje per t'ju dorezuar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " M.C. INERTE " shpk.

U nenshkrua ne Tirane, sot me date 18.2.1998

ORTAKET

CLAUDIO POLESEL

MARK LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 1486 .....REP.
NR. 388 .....KOL.

18845/10 S E Bozo. 11 02 2005

KERKESE 11 KORRIK 2005

KERKUESI : Mark Luli , administrator i shoqerise "M.C.INERTE " Sh.P.K .

OBJEKTI ;Kerkoj depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE "

BAZA LIGJORE :Ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane . Aktualisht shoqeria perbehet nga ortaku i vetem Mark Luli me administrator Mark Luli , me gjendje kapitali te regjistruar 52.803.465 leke .

Me daten 06.07.2005 me vendimin Nr 9 te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise, me kontribut ne para.

Zmadhimi i kapitalit eshte ne shumen 11.300.322 leke dhe per kete qellim eshte bere dhe depozitimi ne banke ne shumen perkatese gje e cila vertetohet nga konferma bankare Nr 0097015 dt 06.07.2005.

Kapitali i shoqerise pas ketij zmadhimi do te jete ne shumen 64.103.687 leke dhe do te jete pronesi te ketij ortaku .

Kerkoj te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 06.07.2005.

KERKUESI
Mark Luli

18345/8

KERKESE

KERKUESI : Mark Luli, administrator i shoqerise "M.C.INERTE" Sh.P.K .

OBJEKTI ;Kerkoj depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE "

BAZA LIGJORE :Ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane . Aktualisht shoqeria perbehet nga ortaku i vetem dhe administrator Mark Luli me gjendje kapitali te regjistruar 45.100.000 leke .

Me daten 02.12.2004 me vendimin Nr 8 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurive te saj. Ortaku i vetem i kerkoi gjykates per kete vleresim emerimin e ekspertit .

Gjykata e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr 18845/8 dt 03.12.2004 ka emeruar ekspert z.Teit Gjini.

Me dt 14.12.2004 ortaku i vetem pasi u njoh me aktin e vleresimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise , paraqitur nga eksperti Teit Gjini per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "M.C.INERTE " nga 45.100.000 leke ne 52.803.465 leke e miratoi kete akt.

Shtesa e kapitalit vjen si rezultat i kalimit te fitimeve te mbartura deri me 31.12.2003 ne kapitalin themeltar, siç pasqyrohen ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar. Ortaku vendosi te regjistrohet kapitali 52.803.465 leke ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

Kapitali i shoqerise pas ketij zmadhimi do te jete ne pronesi te ortakut .

Ortaku do te kete ne pronesi 52.803.465 leke

Kerkoj te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 14.12.2004, Raporti i ekspertit kontabel te autorizuar.te paraqitur nga eksperti Teit Gjini dt 14.12.2004.

KERKUESI
Mark Luli

18845/8 **KERKESE** 3 A Xhoxha 02.12.2004 12 2004

KERKUES ;Mark Luli , administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE" Sh.P.K, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

OBJEKTI ;Kerkoj depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " Sh.P.K

BAZA LIGJORE :Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE "Sh.P.K eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Aktualisht kjo shoqeri perbehet nga ortaku i vetem dhe administrator Z.Mark Luli .Me daten 02.12.2004 ortaku i vetem i kesaj shoqerie ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurise se saj ardhur si rezultat i fitimit te pashperndare.

Ky ortak ka vendosur te caktoj ekspert Z.Teit Gjini.Ortaku i vetem i kerkon gjykates miratimin e ketij eksperti per te bere vleresimin e pasurive te saj.

Kerkoj te depozitohen ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 8 dt 02.12.2004 .

KERKUES
Mark Luli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 598. REP

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt 2.12.2004 para meje noterit u paraqit personalisht Mark Luli , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit.

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

NOTERE
NOTER
IRMA BRACANI

V E N D I M NR 8 DT 02.12.2004
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "M.C.INERTE" SH.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " Sh.P.K eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.Aktualisht kjo shoqeri perbehet nga ortaku i vetem dhe administrator Mark Luli . Me daten 02.12.2004 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurive te saj ardhur si rezultat i fitimit te pashperndare .

Pasi e shqyrtoi kete problem ortaku i vetem

V E N D O S I

1.Te caktoj ekspert per vleresimin e pasurive te saj Z.Teit Gjini. Ortaku i vetem i kerkon gjykates miratimin e e ketij eksperti per te bere vleresimin e pasurive te saj.

2.Te depozitohet ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 8 dt 02.12.2004

ORTAKU I VETEM
Mark Luli
Mark Luli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 599 REP

V E R T E T I M

Ne Tirane sot me dt 2.12.2004 para meje noterit u paraqit personalisht Mark Luli , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE IRMA R. BROQI NOTERE TIRANE

Ni apostile falsifikimi e ordinës

NOTER

NOTERE
IRMA BROQI

18845/6

KERKESE

KERKUES: Mark Luli dtl 1962, lindur ne Puke dhe banues ne Tirane me nr pasaporte 0500148

OBJEKTI ;Depozitimin e dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " M.C.INERTE "

BAZA LIGJORE : Ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrat tregtar "

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Une kerkuesi ortak i vetem dhe administrator i shoqerise "M.C.INERTE " Sh.P.K me vendimin Nr 6 te ortakut te vetem dt 09.10.2002 kam vendosur ;
-Pranimin ne shoqeri te ortakut Ilir Xhemal Shtufi . dhe Xhemal Shtufi.
Ortakut te pranuar ne shoqeri u kam shitur pjese nga kapitali themltar i shoqerise sipas kontrates se shitjes dt 10.10.2002
Kerkoj depozitimin e ketyre dokumentave ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .

11.10.2002

KERKUESI
Mark LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 28 45 rep

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt 10.10.20002 para meje noterit u paraqit personalisht Mark Luli, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti itij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noetrt une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER

(6)

18842/5

KERKESE

KERKUESI : Mark Luli administrator i shoqerise M.C.INERTE

OBJEKTI ;Kerkoj depozitimin ne Zyren e Regjistrit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " ne baze te Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe Ligjit 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr 18849 dt 20.02.1998 te Gjykates se shkalles se Pare Tirane . Aktualisht eshte ortak i vetem dhe administrator Mark Luli me gjendje kapitali te regjistruar 100.000 leke

Me daten 25.05.2002 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurive te saj. Ortaku i vetem i kerkoi gjykates per leje vleresim emerimin e ekspertit.

Gjykata e shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr 18845 /4 ka emeruar ekspert z.Teit Gjini.

Eksperti pasi vleresoi kredite e dhena nga ortaku per blerjen e aktiveve te qendrueshme dhe per kapital punues ne shumen 45.000.000 (dyzet e pese milion) leke . Me dt 19.06.2002 ortaku i vetem pasi u njoh me aktin e vleresimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise , paraqitur nga eksperti Teit Gjini per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "M.C.INERTE " nga 100.000 leke ne 45.100.000 leke e miratoi kete akt.

Kapitali i zmadhuar vjen nga blerja e aktiveve te qendrueshme dhe per kapital punues siç pasqyrohen ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar. Ortaku vendosi te regjistrohet kapitali 45.100.000 leke ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane .

Kapitali i shoqerise pas ketij zmadhimi do te jete ne pronesi te ortakut.

Ortaku do te kete ne pronesi 45.100.000 leke

Kerkoj te depozitohen ne Zyren e Regjistrit tregtar te Gjykates Tirane vendimi i ortakut te vetem dt 19.06.2002, Raporti i ekspertit kontabel te autorizuar te paraqitur nga eksperti Teit Gjini

KERKUESI
Mark LULI

18.845/3

Nr. 06. **KERKESE**

KERKUES ;Mark LUli i biri i Nikolles , dtl 1961,lindur ne Puke dhe banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote jurisike per te vepruar.

OBJEKTI ;Kerkoj depozitimin ne zyren e regjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " Sh.P.K ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " M.C.INERTE " eshte regjistruar person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se shkalles se pare Tirane . Aktualisht ortaku i vetem dhe administrator eshte Mark LUli .Me daten 25.05.2002 ortaku i vetem ka vendosur te zmadhoj kapitalin e shoqerise me vleresimin e pasurise se saj dhe te shtoj objektin e veprimtarise edhe me tregetim me shumice dhe pakice te gjtha materialeve te ndertimit . Ka vendosur te kerkoj ekspert per vleresimin .Ortaku i vetem i kerkon gjykates miratimin e kerkeses per te bere vleresimin e pasurive te saj.

Kerkoj te depozitohen ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates Tirane vendimi I ortakut te vetem.

KERKUES
Mark LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2931 REP

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt -11.06.-2002 para meje noterit u paraqit personalisht Mark Luli, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te

18845/2
06/03/2002

3 A Copo
05.03.2002
05 MAR. 2002

KERKESE

KERKUESI Mark LULI , me banim ne Tirane , me cilesine e administratorit te shoqerise .
0BJEKTI : Depozitimin e vendimit nr. 1 date 12.01.2002 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MC INERT " SH.P.K Tirane
BAZA LIGJORE : Ligji nr. 7667 date 20.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar"

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendim nr. 1 date 12.01.2002 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MC INERT " SH.P.K Tirane

- Shitje e kuotave te kapitalit te shoqerise .

Po depozitohet
06.03.2002

KERKUESI
MARK LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR REP
102

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 04.03.2002, para meje noteres Xhevahire Brahaj, u paraqit personalisht Mark LULI , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentat e tij personale cili nenshkroje kerkesen e mesiperme ne prezencen time.Une noterja vertetoj nenshkrimin e tij konforme ligjit

NOTERE
XHEVAHIRE BRAHAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE

(3) 17845/1 04.06.01

30 MAG. 2001

30.05.2001

KERKESE

KERKUESI : Mark LULI , banues ne Tirane Rruga "Durresit" administrator i shoqerise " M.C.INERTE" SH.P.K Tirane .

OBJEKTI : Depozitim te vendimit nr.1 te asambles ortakeve te shoqerise "M.C.INERTE" sh.p.k date 28.05.2001.

BAZA LIGJORE : Ligji nr. 7667 date 20.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar"

Të depozitohet hëshera ollne dhënë me 01.06.2001 Gjykatës e Rrethit Tiranë

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendimin nr. 1 date 28.05.2001, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "M.C.INERTE" sh.p.k , me seli ne Tirane , eshte vendosur ;

- Shtese e objektit te veprimtarise per aktivitetin ndertim sipas liçenses.

Kerkojme nga gjykata e rrethit Tirane depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar prane kesaj gjykate duke u bere ndryshimet perkatese .

- Vendim i Asamblesë së Jashtëzakonshme Nr. 709 dt. 28.05.2001
- Kontratë - punë dt. 30.05.2001
- Çiçensë Z 1021/2

KERKUESI

MARK LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR REP
907-

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 28.05.2001, para meje noteres Xhevahire Brahaj, u paraqit personalisht Mark LULI , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova ng pasaporta e tij , i cili nenshkroje kerkesen e mesiperme ne prezencen time.une noterja vertetoj nenshkrimin e tij konforme ligjit

NOTERE
XHEVAHIRE BRAHAJ

K E R K E S E

PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Claudio, lindur me 1955, banues
e pasaporte 361488 J.
e me 1962, me zotesi te plote pe

i Person Juridik i Shoqerise me
E" shpk.

ATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ortak te Shoqerise me Pergje
ekt veprimtarie sipas aktit te t

nte ne Tirane, Rr." Durresit ",

qerise jane te dy ortaket.

shte 100.000 leke .

se do te jete mbi 10 vjet.

e kushtet ligjore, kerkojme regjistrimin e shoqerise

K E R K U E S

CLAUDIO POLESEL MARK LULI

Po e regjistroj
ne
dt. 20-02-90
gjykatore
K.K. Dedi

V E N D I M NR 9 dt 06.07.2005
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "M.C.INERTE " SH.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "M.C.INERTE " eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr 18845 dt 20.02.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Aktualisht shoqeria perbehet nga ortaku i vetem Mark Luli , me administrator Mark Luli , ne gjendje kapitali te regjistruar 52.803.465 leke . Me daten 06.07.2005 ortaku i vetem

V E N D O S I

- Te zmadhoj kapitalin e shoqerise me kontribut ne para.
Ky kapital pasi ketij zmadhimi do te behet 64.103.687 leke.
-Te depozitohen ne Zyren e Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane vendimi i ortakut te vetem Nr 9 dt 06.07.2005.

ORTAKU
Mark Luli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 6994 REP

TAKSA U LIKUJDUA

V E R T E T I M

Sot me daten 08.7.....2005 para meje noterit u paraqit personalisht Mark Luli , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote.Pasi nenshkroi rregullisht para meje noterit une e vertetoj ate sipas ligjit .

NOTERE NOTER
DRITA PEPI
TIRANE

GJINI
Registered Auditors

Adresa Rr. Vaso Pasha
Pall. 26/2 Ap.11
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 267 538
Fax: (+355 4) 267 538
email: tgjini@sanx.net

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Mbi Pasqyren Financiare te Kapitaleve te Veta te Shoqerise per qellim te zmadhimit te kapitalit themeltar:

«MC Inerte« Shpk

Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2003

Dhjetor 2004

Permbajtja

I. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

II. PASQYRA FINACIARE E KAPITALEVE TE VETA TE SHOQERISE PER QE LLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR.

